

## MARRËVESHJE PËR DHURIM KUOTE

Sot me datë 15/02/2019, mbledhet Asambleja e Ortakëve të shoqërisë **3ALH SH.P.K** e themeluar sipas legjislacionit shqiptar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numer NIPT- **L72111038E** me seli në Tiranë në adresën Lagjia Nr. 2, Rruga Skenderbeu, Ndertese private Nr. 9, Kati 1, Kodi Postar 1030, Kamëz. Ortaket e shoqërisë Z. Erald Boja 50%, Znj. Adela Preçi 25% dhe Znj. Ledina Çullhaj 25% të cilet me vullnetin e tyre të lire vendosen:

### **Dhuruesit:**

1. Znj. **Adela Çullhaj Preçi**, e bija e Hysniut, e datelindjes 07/08/1985, lindur dhe banuese në Tiranë, Rr. Ilia Shyti, Nr.20, me zotësi të plote juridike për të vepruar, e identifikuar me letërnjoftimin nr.024469721 e nr.personal I55807044E; dhe
2. Znj. **Ledina Çullhaj**, e bija e Hysniut, e datelindjes 10/07/1995, lindur dhe banuese në Tiranë, Rr. Ilia Shyti, Nr.20, me zotësi të plote juridike për të vepruar, e identifikuar me letërnjoftimin nr.032254753 e nr.personal J55710091F

Dhe

### **Përfituesi:**

3. Z. **Erald Boja** i biri i Lutfiut, i datelindjes 01/06/1981, lindur dhe banuese në Kamëz, Tiranë, Rr. "Skenderbeu", Lagjia nr.2, objekti nr.15, me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me letërnjoftimin nr.025718326 e nr.personal I10601211C,

( se bashku të referuar "Palët"

### **DUKE QENE SE:**

A. Dhuruesit janë administrator si edhe ortakë në kapitalin e shoqërisë "3ALH" sh.p.k me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NIPT - L72111038E, dhe me seli në Kamëz, Lagjia Nr.2, Rruga "Skenderbeu", Ndertese private Nr.9, Kati 1, Kodi Postar 1030, Shqipëri (referuar me poshtë si "Shoqëria");



B. Ne momentin e nënshkrimit të kësaj Marreveshje, Dhuruesit zoterojnë se bashku 50% të kuotave që përbejnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, dhe secili veç e veç 25% të kapitalit të shoqërisë;

C. Dhuruesit deshirojnë të dhurojnë Përfituesit dhe Përfituesi pranon të përfitojë, kuotat e zotëruara prej tyre, kuota që përbejnë 50% të kapitalit të Shoqërisë (me tej referuar si “**Kuota**”)

D. Palet kanë vendosur të lidhin këtë Marreveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kritereve të angazhimit të tyre respektiv për dhurimin e Kuotave.

## PALET BIEN DAKORD SA VIJON:

### 1. PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

#### 1.1 Përkufizime

Termat me shkronja të mëdha shtypi në këtë Marreveshje do të kenë kuptimin e përcaktuar në vijim:

“ **Barrë** ” nënkupton çdo pretendim, interes apo e drejtë e çdo individit (duke përfshirë çdo të drejtë për të blerë, mundësi për të blerë në të ardhmen apo të drejtë parabletjeje) ose çdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigures (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajtje të drejtë ose çdo marreveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër barrësues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjetër për pagim me reserve;

“ **Qendra Kombëtare e Biznesit** ” nënkupton organin publik Shqiptar që ka kompetencën e regjistrimit në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

### 2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### 2.1 Dhurimi i kuotave

2.1.1 Në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marreveshje, Dhuruesit dhurojnë duke kaluar në pronësi të plotë të Përfituesit dhe Përfituesi përfiton nga Dhuruesit Kuotën, të lirë dhe të parënduara me ndonjë Barrë.

2.1.2 Transferimi i Kuotës bëhet në përputhje me këtë Marreveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

2.1.3 Titulli i porosisë mbi Kuotën transferohet tek Përfituesi me lidhjen e kësaj Kontrate, dhe Kuota do të dhurohet sëbashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre nga data 15/02/2019 (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin ,

shperndarjen ose ndonje kthim te kapitalit te deklaruar, te paguar ose te realizuar nga Shoqeria deri me sot).

## **2.2 Vendimi i ortakut**

Dhuruesit deklarojne se e miratojne kete dhurim kuotash dhe se kete miratim e reflektojne ne vendimin e ortakeve te Shoqerise qe vendos mbi miratimin e transferimit te Kuotes nga Dhuruesit tek Përfituesi.

## **3.DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **3.1 Marreveshja dhe Amendamentet**

3.1.1 Kjo Marreveshje zhvlefte son cdo marreveshje te meparshme ndermjet Paleve ne lidhje me objektin e kesaj Marreveshje.

3.1.2 Cdo ndryshim i kesaj Marreveshje eshte i vlefshem vetem nese eshte bere me shkrim dhe eshte nenshkruar prej ose ne emer te seciles prej Paleve dhe i referohet ne menyre specifike kesaj Marreveshje.

### **3.2 Transferimi**

Kjo Marreveshje do te jete e detyrueshme per zbatim dhe do te zbatohet edhe prej pasardhesve te Paleve por nuk do te jete e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim te Paleve te tjera.

### **3.3 Regjistrimi i Marreveshjes**

Palet bien dakord se regjistrimi i Marreveshjes ne Qendren Kombetare te Biznesit do te behet nga Përfituesi brenda dates 31 Mars 2019.

## **4.LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare. Palet bien dakort qe cdo marreveshje qe lind ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin apo zbatimin e Marreveshjes te zgjidhet nepermjet Gjykates se Rrethit Gjyqeor Tirane.

\*\*\*

Akti u redaktua konform vullnetit te plote te paleve te cilet pasi lexuan Marreveshjen e nenshkruan rregullisht.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

*Erald Boja*



*Adela Çullhaj Preçi*



*Ledina Çullhaj*

